



STRASBOURG, FRANCË:
ZHVILLOHET MBLEDHJA E
KONFERENCËS EVROPIANE
TË AVIACIONIT CIVIL (ECAC)
Drejtori i AAC ka marrë pjesë
në takimin e 36-të të ECAC...

faqe 2



KODI I RI AJROR:
DEPUTETËT E KOMISIONIT
TË VEPRIMTARISË
PRODHUESE, TAKIM NË AAC
Njihën me reformat e
ndërmarra në aviacion në 8
muaj...

faqe 3

Gusht 2018 - Botimi IV

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



TIRANË

AAC BASHKËPUNIM
ME ORGANIZATËN
E NJOHUR "JAA",
TRAJNOHEN 10
INSPEKTORË NË SMS

faqe 4

STATISTIKA

RRITET NUMRI I
PASAGJERËVE PËR
MUAJIN QERSHOR

Një lajm pozitiv vjen në muajin
Qershor, ku regjistrohet rritje e
numrit të pasagjerëve krahasuar
me të njëjtën periudhë të vitit
2017. 17,739 pasagjerë më
shumë se në 2017...

TË REJAT E FUNDIT

RRITET NUMRI
I VONESAVE NË
BASHKIMIN EUROPIAN.
JA MASAT PËR
ZGJIDHJE

Nga të dhënat zyrtare të
Eurocontrol, rezultojnë se numri
i vonesave në 6 muajt e parë të
2018 është dyfishuar. Në shifra
vonesat shkojnë 47,000 minuta
në ditë, 133% më shumë se në
2017...



RAPORTI I PERFORMANCËS

MUAJI KORRIK, REKORD VONESASH

NGA KOMPANIA BLUE PANORAMA

faqe 6

STRASBOURG, FRANCË: ZHVILLOHET MBLEDHJA E KONFERENCËS EVROPIANE TË AVIACIONIT CIVIL (ECAC)

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar Krislen Keri, ka marrë pjesë në takimin e 36-të të ECAC që zhvillohet 1 herë në 3 vjet. Në mbledhjen ku morën pjesë drejtorët e Autoriteteve të Aviacionit Civil pjesë e ECAC, Presidentja e ICAO-s Fang Liu, Drejtori Ekzekutiv i EASA-s Patrick Ky dhe menaxheri i IATAs Alexandre de Juniac, u diskutua për sfidat e aviacionit që lidhen me rritjen e kërkesës, menaxhim më të mirë të trafikut, siguria, përmirësimi i kapaciteteve njerëzore e teknike, ulja e emetimit të gazrave dhe siguria kibernetike. Drejtori i AAC-së Krislen Keri, gjatë kësaj mbledhje u takua me homologun e tij Italian Alessio Quaranta, me të cilin diskutoi për problemet që po shkaktojnë kompanitë italiane me të drejtat e pasagjerëve, me vonesa apo anulime përtej normave. Keri, tha se pala shqiptare kërkon masa nga pala italiane, që këto kompani të penalizohen sipas rregulloreve evropiane nga Autoritetet Italiane, që janë edhe licencuesit e tyre. Gjithashtu ai nënvizoi se për këto problematika ka venë në dijeni edhe Komisionin European. Gjatë punimeve Keri u takua edhe me Drejtorin e Aviacionit Civil turk, z.Bahri Kesici, me të cilin u diskutua për forcimin e bashkëpunimit në aspekte që lidhen me ndërtimin e kapaciteteve dhe shkëmbim in e eksperiencave të suksesshme të palës turke, si dhe funksione të tjera që lidhen me kompanitë ajrore. Z. Keri gjithashtu zhvilloi takime me sekretarin ekzekutiv të ECAC Salvatore Sciacchitano, të cilin e njohu me zhvillimet më të fundit në Aviacionin Civil shqiptar, nga i cili mori mbështetjen për reformat e ndërmarra. Një tjetër takim me rëndësi ishte ai me Drejtorin e Përgjithshëm të Aviacionit Civil të Izraelit, z. Joel Feldschuh, me të cilin u diskutuan eksperiencat konçensionare të aeroporteve të të dy vendeve, ku Izraeli është në proces për dhënien me konçension të dy aeroporteve në vend. Ata ranë

dakord për vendosjen e kanaleve të bashkëpunimit për të përfituar nga praktikat më të mira në këtë fushë. Në takim u diskutua çështja e vonesave të fluturimeve në gjithë kontinentin European, ku vetëm për vitin 2018 pritet që vonesat të shkojnë 14.3 milion minuta ose 27 vjet! Kjo për shkak të kapaciteteve përpunuese të kompanive, aeroporteve apo sistemeve navigacionale në Evropë. Në mënyrë që të përballohen sa më mirë këto sfida palët u angazhuan të punojnë më shumë në 3 shtylla kryesore, që



Në foto:

Drejtori i AAC z. Krislen Keri gjatë konferencës së 36 të ECAC

lidhen me përmirësimin e sigurisë, rritjen e kapaciteteve teknike, por edhe përmirësimin e shërbimeve në tokë.



Në foto:

z. Krislen Keri me z. Alessio Quaranta, drejtor i ENAC, dhe me z.Bahri Kesici, drejtor i AAC së Turqisë



Foto:

Gjatë konferencës së 36 të ECAC që u zhvillua në Str

KODI I RI AJROR: DEPUTETËT E KOMISIONIT TË VEPRIMTARISË PRODHUESE, TAKIM NË AAC

Në kuadër të konsultimeve për Kodin e Ri Ajror të Republikës së Shqipërisë, deputetët e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, kanë zhvilluar një vizitë në ambientet e Autoritetit të Aviacionit Civil, duke parë nga afër ndryshimet dhe diskutuar për draft kodin. Gjatë takimit me drejtorin e AAC-së Krislen Keri dhe stafin e autoritetit, deputetët u njohën me reformën që ka filluar në institucion prej disa muajsh. Keri informoi deputetët se një hap i parë i ndërmarrë ishte ndryshimi i strukturës, nga një institucion me rreth 85 punonjës në drejtori dhe 38 në aeroportin e Kukësit, numri shkoi në 70 punonjës në drejtori, 9 në Kukës, duke ulur shpenzimet e panevojshme. Institucioni u ristrukturua nga 9 drejtori në 5 të tilla sipas modeleve dhe rekomandimeve europiane, ndër vite por të pa zbatuara. Një hap i rëndësishëm Keri tha se është hedhur në fushën e të drejtave të pasagjerit, ku përveç hapjes së një zyre të dedikuar në Aeroportin



Ndërkombëtar Nënë Tereza, falë asistencës të AAC janë kompensuar 160 pasagjerë, me nga 250 euro secili, për shkak të vonesave apo anulimeve të fluturimeve nga kompanitë që operojnë me tregun Italian. Gjithashtu janë vendosur tabelat informuese në ambientet e Aeroportit "Nënë Tereza" të cilat informojnë pasagjerët se si të kërkojnë të drejtat e tyre. Këto kompensime kanë ndodhur për herë të parë 25 në vite aviacion. Një aspekt i rëndësishëm Keri tha se institucioni i jep transparencës dhe komunikimit me publikun, ku çdo muaj, publikohet Buletini mujor, pjesë e të cilit është

edhe raporti i performancës së çdo kompanie ajrore, që lidhet me vonesat dhe anulimet e fluturimeve, duke rekomanduar qytetarët me cilat linja duhet të kenë kujdes. Zhvillimi i industrisë ajrore ka marrë vëmendje në këto 7 muaj, ku është kryer studimi i Fizibilitetit për Aeroportet e Jugut, për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës dhe të Sarandës. Më parë s'ka patur asnjë lloj studimi në fushën e aviacionit, përfundoi Keri. Deputetët e Komisionit, bënë disa pyetje në lidhje me Kodin e ri Ajror si dhe u angazhuan për mbështetje që të kalojë në sesionin e ri parlamentar në vjeshtë.



Në foto:

Drejtori i AAC z. Krislen Keri dhe z. Eduart Shalsi gjatë takimit

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL: BASHKËPUNIM ME ORGANIZATËN E NJOHUR “JAA”, TRAJNOHEN INSPEKTORËT NË SMS

Autoriteti i Aviacionit Civil ka nënshkruar një marrëveshje me organizatën prestigjioze të trajnimit në aviacion “JAA”. Një nga ekspertët më të mirë të saj ka qëndruar për disa ditë në Tiranë, duke trajnuar 10 inspektorët e AAC-së, në sistemin efektiv të menaxhimit të sigurisë. Trajnimi u zhvillua në datat, 24-26 Korrik 2018 në ambientet e AAC, ku dhe u mbajt kurs “ICAO & EASA Safety management System Requirements”. Ky kurs kishte për qëllim zhvillimin dhe implementimin e një Sistemi efektit të Menaxhimit të Sigurisë, si një nga sfidat e organizatave të aviacionit. Ky kurs u mundësoi inspektorëve të AAC-së njohjen me sfidat, mjetet, njohuritë dhe metodologjinë për të implementuar një SMS të suksesshme si dhe për t’i përmbushur kriteret e ICAO-s, Aneks 19 dhe Doc 9859, por gjithashtu edhe me kërkesat e EASA-s përcaktuar qartazi në ligjet e Aviacionit Europian. Në këtë kurs u trajtuan tema si Programi i Sigurisë Shtetërore, SMS



Foto:
gjatë trajnimit të SMS me inspektorët në zyrat e AAC

e ofruesit të shërbimeve, identifikimi i riskut dhe parimet e përgjithshme, performanca e parrezikshmërisë lidhur me indikatorët dhe promovimin e konceptit të sigurisë. Në fund të këtij kursi inspektorët e AAC-së ju

nënshtruan një provimi të cilën të gjithë e kaluan me sukses, duke marrë dhe certifikatat përkatëse të JAA. Ky bashkëpunim me JAATO, do të vijojë edhe me trajnime dhe kurse të tjera në të ardhmen.



Në Foto:
eksperti i “JAA” gjatë trajnimit të SMS me inspektorët në zyrat e AAC

IATA: RRRITET NUMRI I VONESAVE NË BASHKIMIN EUROPIAN, MASAT PËR ZGJIDHJE

Organizata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA), i ka bërë një apel të fortë ofruesve të shërbimeve navigacionale në kontinentin evropian dhe qeverive, që të zgjidhin problematikat e hasura në pjesën e parë të këtij viti që lidhen me vonesat e mëdha të fluturimeve. Alexandre de Juciac CEO i IATAs në një deklaratë për mediat, shkruan se tani Europa është në sezonin turistik, dhe udhëtarët duan të kenë fluturimin e tyre në kohë. Por shumë prej tyre janë të zhgënjyer për shkak të vonesave të fluturimit. Ne duhet të bëjmë më shumë progres, por vonesat janë dyfishuar krahasuar me vitin e kaluar. Nuk ka një zgjidhje të shpejtë për këtë shqetësim në 2018. Por zgjidhjet e duhura janë shumë të ditura nga të gjithë ne. Me investimet e duhura të qeverive dhe përmirësimin ANSP-

ve kjo mund dhe duhet të arrihet të bëhet në vitin 2019. Nga të dhënat zyrtare të Eurocontrol, rezulton se numri i vonesave në pjesën e parë të 2018 është dyfishuar, me një shifër që shkon në 47,000 minuta në ditë, 133% më shumë se në 2017. Shumica e këtyre vonesave kanë si shkak kryesor, mungesën e kapaciteteve njerëzore të kompanive dhe ofruesve të shërbimeve, grevave apo kushteve të motit. Por edhe rritja e madhe kërkesës nga pasagjerët në periudha të caktuara. Në muajin Korrik kulmi i vonesave shkoi në 337 minuta më e gjata, dhe 20 minuta më e ulëta në ditë. IATA rekomandon shtetet e Bashkimit Evropian që të marrin masa urgjente në 4 drejtime kryesore.

1.Modernizim të infrastrukturës dhe implementim të nismës për një Qiell të Përbashkët Evropian, ATM/

SEADAR për të cilën kompanitë janë duke paguar.

2.Rekrutimi i stafit shtesë, dhe aplikimi i modeleve më të mira të menaxhimit.

3.Të forcohet rrjeti i menaxherëve Evropian në mënyrë që rrjeti të plotësojë kërkesat e pasagjerëve.

4.Të forcohet skema e performancës në mënyrë që ato ANSP që nuk përballen dot me fluksin, të jenë objekt i masave më të forta penalizuese.

Sipas kreut të IATAs vonesat për shkak të ATC janë totalisht të papranueshme dhe me impakt të madh në ekonomi. Por kreu i IATAs u rezervua në kritikën ndaj kompanive ajrore, duke qenë se IATA është edhe avokatja kryesore e tyre. Ndërkohë nga aktorë të tjerë në aviacion, kompanitë kanë një përgjegjësi të madhe në këtë situatë.



Në foto:

Drejtori i Përgjithshëm i IATA-s, Alexandre de Juciac

RAPORTI I PERFORMANCËS

Muaji Korrik i këtij viti, shënon dhe periudhën më problematike që është regjistruar në shumë vite përse i përket performancës së kompanive, duke patur si indikator vlerësues respektimin e orareve të nisjes apo anulimet e palajmëruara të fluturimeve. Nga të dhënat që Autoriteti ka, rezultojn se kompania më problematike në këtë muaj është “Blue Panorama”, me itinerare qytete të ndryshme të Italisë. Kompania “Blue Panorama”, numëron 26 vonesa mbi 2 orë duke afektuar një numër të madh pasagjerësh. Kompania interesit të vazhdueshëm të Autoritetit, i është përgjigjur se ka probleme operacionale. Ndërsa vihet re një përmirësim i dukshëm i performancës nga disa kompani të tjera, që në muajt e mëparshëm kishin regjistruar probleme me vonesa apo anulime të fluturimit.

Në tabelën në të djathtë paraqiten edhe numrat e saktë me vonesa dhe anulime të fluturimeve gjatë muajit Korrik 2018.

KOMPANIA		JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK
BLUE PANORAMA	Vonesa mbi 2 orë	1	1	4		3	3	26
	Anullime							6
ALBAWINGS	Vonesa mbi 2 orë						1	5
	Anullime							1
FLY ERNEST	Vonesa mbi 2 orë	5		1	9	5	1	1
	Anullime				3	1		2
LUFTHANSA	Vonesa mbi 2 orë		1				1	1
	Anullime				1			2
AUSTRIAN	Vonesa mbi 2 orë						1	1
	Anullime				1	1		
LUFTHANSA	Vonesa mbi 2 orë		1				1	1
	Anullime				1			2
WIZZ AIR	Vonesa mbi 2 orë	1						2
	Anullime							
BRITISH AIRWAYS	Vonesa mbi 2 orë		1	1	1			1
	Anullime							
PEGASUS	Vonesa mbi 2 orë							1
	Anullime							
TURKISH	Vonesa mbi 2 orë	1		2	1			
	Anullime							
ADRIA	Vonesa mbi 2 orë	1	1	2	1			
	Anullime							
VOLOTEA	Vonesa mbi 2 orë				1			
	Anullime							

Tabela përkatëse

TË DREJTAT E PASAGJERIT

Si rrjedhojë e plotësimit të numrit të madh të formularëve nga pasagjerët është rritur numri i kompensimeve gjatë muajit Korrik 2018, nga 140 që ishte në muajin e kaluar shifrat shkojnë në 160, duke u rritur me 20 pasagjerë që do të marrin rreth 250 euro kompensim për vonesat mbi 3 orë të kompanive ajrore. Shifra pritët të rritet akoma edhe më shumë në muajt në vijim, kjo e lidhur me numrin e madh të formularëve të ankimit, që janë plotësuar nga qytetarët, për shkak të vonesave të shënuara në muajin Korrik. Proçedurat e kompensimit variojnë deri në 6 javë, dhe nëse kompania nuk i jep qytetarit përgjigjen e duhur. Atëherë çështja ndiqet nga ekspertët e AAC-së, me kërkesë të vetë pasagjerit.




KOMPENSIME



Deri në muajin Maj 2018 numri i kompensimeve ishte 80, në Qershor në 60, Korriku me 20 kompensime, në total numri shkon në 160 kompensime.

KOMPENSIMET E PASAGJERËVE



ANALIZA STATISTIKORE PËR MUAJIN QERSHOR 2018


QERSHOR 2018: Një tjetër lajm pozitiv vjen nga fusha e aviacionit, ku në muajin Qershor është regjistruar rritje e pasagjerëve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Në shifra konkrete rritja është me 17,739 pasagjerë më shumë se në 2017. Më poshtë keni edhe grafikët dhe tabelat e detajuara me numrin e pasagjerëve dhe të fluturimeve charter, që gjithashtu shënojnë rritje.

PËRQINDJET: Referuar të dhënave të paraqitura në grafikun e muajit Qershor, kompania ajrore “Blue Panorama” është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Qershor 2018, me 18% të totalit. Ndjekur nga “Albawings” me 12% të totalit, “Ernest s.p.a” me 10% të totalit dhe Alitalia me 9% të totalit mujor. Nisur nga këto të dhëna Italia vazhdon të zotërojë përqindjen më të madhe të tregut të transportit ajror për muajin Qershor 2018, duke zënë 49% të totalit, ndjekur nga Turqia me 9%. Nëse referuar shifrave do të analizonim ecurinë e tregut të transportit ajror në vendin tonë për muajin Qershor 2016-2017-2018, vëmë re se kemi një rritje të numrit të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit, vit pas viti.


Po ta krahasojmë me muajin Qershor 2016 diferenca është 48,109 më shumë pasagjerë në 2018.

CHARTER: Në Qershor të 2018 shifra shkon në 44.392 pasagjerë më shumë, krahasimisht me vitin 2017, ka pasur rritje nga viti 2016 në vitin 2017 duke shënuar një rritje të fluksit. Sipas të dhënave në tabelën më poshtë vëmë re se numri i pasagjerëve që fluturojnë me charter ka pësuar një rritje nga viti në vit ndaj totalit të pasagjerëve. Por në vitin 2018 është më e dukshme rritja pasi ato përbëjnë 16.42% ndaj totalit, ndërkohë që në 2017 ka qënë 9.30% dhe në 2016, 9.28% dhe këtu nuk përfshihen muajt e pikut që janë Korriku dhe Gushti, ku pritet një rritje e konsiderueshme. Për sa i përket numrit të pasagjerëve të fluturimeve charter për muajin Maj 2018 ka patur trefishim të fluturimeve, që në përqindje shkon në 204.92%, kjo si rredhë e numrit të lartë të turistëve të huaj që kanë zgjedhur të vizitojnë vendin tonë.

PASAGJERË, MUAJI QERSHOR PËRGJATË 3 VITEVE




Grafiku 1:
Numri i pasagjerëve për muajin Qershor përgjatë 3 viteve të fundit



Grafiku 2:
Lëvizja e pasagjerëve që kanë udhëtuar për /nga TIA gjatë muajit Qershor 2018, sipas shoqërive ajrore.

NUMRI I PASAGJERËVE

QERSHOR 2018: Nisur nga të dhënat mbi operatorët ajrorë, përsa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Qershor 2016-2017-2018, vëmë re se numri i pasagjerëve që kanë fluturuar me kompaninë Wizz Air në muajin Qershor 2018 ka shënuar një rritje prej 281.00% e krahasuar me Majin e 2017, sikurse edhe kompania Albawings, e cila ka një rritje prej 84.75% nga Qershori i vitit 2017- Qershor 2018. Kompania ajrore "Transavia" ka humbur treg, duke shënuar një rënie në numrin e pasagjerëve që kanë zgjedhur të udhëtojnë me të në muajin Qershor 2018 me rreth -44% krahasuar me Qershorin e 2017.



Grafiku 3:
Numri i pasagjerëve sipas kompanive për muajin Qershor përgjatë 3 viteve të fundit

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT KORRIK

Drejtoria e ANS zhvilloi në datat 12-13 Korrik 2018, inspektimin pranë Albcontrol në lidhje me Zbatimin e Skemës së Kompetencës së stafit inxhiniero-teknik. Në kuadrin e mbikëqyrjes së vazhdueshme tek ofruesit e shërbimeve navigacionale, Drejtoria e ANS në AAC zhvilloi inspektimin e radhës tek Albcontrol sh.a. Objektivi i këtij inspektimi është verifikimi i përpunshmërisë me rregulloret në fuqi si më poshtë:

1. Urdhëri i Ministrit, Nr 115, Datë 23.10.2012, "Për kërkesat e përbashkëta për ofrimin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror" dhe procedurat që lindin nga ai dhe zbatueshmëria e tyre.
2. "Manuali i NSA version 4.0" viti 2018 "Manuali i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror në Funkcion të Autoritetit Kombëtar të Mbikëqyrjes".
3. Skemën e Kompetencës për ATSEP, Edicioni 1, datë 02.09.2016.



Fushat ku u zhvillua inspektimi janë:

1. Kontrolli i procedurave administrative të vendosura sipas skemës së kompetencës së ATSEP.
2. Ruajtjen e rekordeve për ATSEP.
3. Çdo papërpunshmëri që mund të hasej gjatë inspektimit. Ky proces inspektimi u krye në Drejtorinë e Trajnimit dhe Licencimit në Albcontrol sh.a. Gjatë inspektimit u vu re një përpunshmëri dhe korrektësi në zbatimin e skemës së kompetencës së ATSEP.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në kuadër të rritjes së sigurisë në fluturim ka kryer aktivitetet e mëposhtme gjatë muajit Korrik;

- 1- Sektori i Vlefshmërisë Ajrore ka kryer 2 inspektime fizike për avionë.
- 2- Sektori i Operimeve dhe Mbikëqyrjes së COA ka kryer 2 inspektime në fluturim.
- 3- Sektori i SAFA-s ka kryer 5 inspektime në avionët me regjistrim të huaj të cilët kanë operuar në territorin e Shqipërisë. Nga këto inspektime nuk u konstatuan problematika shqetësuese.

Aviacioni në Botë



BE, RYANAIR PËRBALLET ME GREVA MASIVE, 600 FLUTURIME ANULLOHEN

Kompania më e madhe ajrore në Europë Ryanair, po përballet me probleme për shkak të disa grevave në shumë vende të BE-së. Greva e parë që ka filluar është ajo në Belgjikë e ekuipazheve të kabinave, të cilët shpallën grevë 48 orëshe, duke u ndjekur edhe nga kolegët e tyre në Spanjë, Portugali e Irlandë, çka solli anulimin e 600 fluturimeve. Por situata pritet të përkeqësohet, pasi në datën 10 të muajit gusht, Unionet e Pilotëve të disa shteteve si Spanjë, Portugali apo Irlandë dhe Hollandë,



pritet të mbajnë një grevë disa ditëshe dhe që do të shkaktojë kaos edhe më të madh. Pilotët dhe stafi i Ryanair kërkojnë kushte më të mira pune, si rritjen e fondit për pensionet dhe rritje të pagave. Ndërsa vetë kompania ka një reputacion jo të mirë, ku në të kaluarën janë regjistruar raste të intimidimit të punonjësve dhe kërcënime për largime masive nga puna. Vetë kompania në një deklaratë për mediat tha se kërkon nga Unionet, që të lajmërojnë të paktën 48 orë para mbajtjes së një greve në mënyrë që të mos ketë probleme në vijim e fluturimeve dhe më kryesorja mos të penalizohen pasagjerët. Gjithashtu ata u shprehën se nuk do të ketë marrëveshje kolektive me pilotët, por do të ketë kontrata individuale. Kompania irlandeze ka qendrat e veta operacionale në 37 shtete europiane me një kapacitet vjetor që shkon në 130 milion pasagjerë.

BELGJIKË: DEFEKTI TEKNIK I KULLËS, MBYLL HAPËSIRËN AJRORE PËR 3 ORË

Një defekt teknik në sistemin e kontrollit të hapësirës ajrore, shkaktoi mbylljen e gjithë hapësirës ajrore në Belgjikë për disa orë. Ngjarja që u konsiderua si katastrofë nga autoritetet, nuk është ende e qartë nga se u shkaktua, por dyshohet se mund të ketë patur probleme me çështjet e sigurisë. Vetë zëdhënësi për shtyp i Belgcontrol, tha se po zhvillohen hetime të hollësishme pse ndodhi ky problem teknik, por nënvizoi se siguria e pasagjerëve është prioriteti kryesor. Për rreth 3 orë gjithë fluturimet me destinacion Brukselin u devijuan në aeroportet e shteteve të tjera, ndërsa rreth 20 fluturime u anuluan ose u shtynë. Nga kjo ngjarje ende e paqartë u prekën rreth 730 pasagjerëve.

AUSTRI, ZBULOHET NJË PREDHË NË VALIXHEN E NJË PASAGJERI




Një ngjarje e pazakontë është regjistruar në aeroportin Ndërkombëtar të Vjenës në Austri. Skanerat kanë zbuluar kokën e një predhe që datonte nga Lufta e Dytë Botërore, në çantën e një gruaje që destinacion kishte Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gruaja pasi u mor në pyetje nga ekspertët e antiterrorizmit, u verifikua se nuk kishte qëllime të kryente akte jo ligjore, por e kishte gjetur këtë kokë predhe të pashpërthyer duke ecur dhe donte ta kishte si një suvenir. Edhe pse u konstatua se qëllimi nuk ishte kryerja e ndonjë akti jo ligjor, grua u gjosit me vlerën e 4.000 mijë eurove nga autoritetet.

KLM AIRLINES, PREZANTOHET ROBOTI QË DO TRANSPORTOJË BAGAZHIN

Kompania e njohur ajrore hollandeze KLM, ka deklaruar se prej kohësh ka filluar testimin e një teknologjie të re për të asistuar pasagjerët me bagazhin e tyre të udhëtimit. Robo-karroca do të ndihmojë pasagjerët për transportin e bagazhit pa qenë nevoja për ta shtyrë. Ky mjet i ri inteligjent, do të ketë kapacitet deri në 38 kg, dhe do e çojë bagazhin në vendin e nisjes. Shpejtësia është parashikuar të jetë rreth 5 km në orë, që është edhe mesatarja e një personi. Kjo pajisje e re inteligjente, do të kryejë edhe skanimin e biletës të pasagjerit, dhe në rastet kur ka anulime, bagazhi nuk do të kalojë check-in. Ose në rastet kur do të ketë ndryshime të gatet, roboti do e çojë bagazhin në vendin e caktuar. Prezantimi i parë i kësaj teknologjie do të ndodhi gjatë këtij viti në aeroportin John F. Kennedy në New York.

ATLANTA, SHBA: AEROPORTI ME NUMRIN MË TË MADH TË PASAGJERËVE NË BOTË



Aeroporti i Atlantës Hartsfield-Jackson në SHBA, vijon të regjistrojë numrin më të madh të pasagjerëve në rang botëror, duke vijuar të jetë dhe aeroporti me numrin më të madh të udhëtarëve. Nga të dhënat zyrtare që vijnë nga Këshilli Ndërkombëtar i Aeroporteve, 103 milion pasagjerë zgjedhën të udhëtojnë në këtë aeroport gjatë 2017, 8 milion pasagjerë më shumë se aeroporti i dytë më i madh në Botë ai i Pekinit në Kinë. Sipas shifrave janë regjistruar 879 mijë fluturime në total, një sfidë e madhe për gjithë personelin e ofrimit të shërbimeve në tokë. Aeroporti i tretë renditet ai i Dubait, me një shifër që shkon në 88 milion pasagjerëve në 2017. Ndërsa në vendin e 4-të renditet aeroporti Haneda në Japoni, me një shifër që shkon në 85 milion pasagjerë. Lista vijon me aeroportet e Los Angelos në SHBA. Duke e kthyer SHBA-në në vendin me numrin më të madh të udhëtarëve në Botë, kjo falë edhe rritjes ekonomike. Aeroporti i më i madh europian renditet Heathrow i Londrës me 78 milion pasagjerë në 2017, ndërsa në nivel botëror renditet në vendin e 7-të.